



## REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

---

KA.nr.93/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit MERCOM Company SH.P.K., me NRB 70191751, dhe me seli në Rr. “Fazli Grajqevci” nr. 20/3, Prishtinë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit tutje (OSHP), me seli në Prishtinë. Adresa: Rr. “Migjeni”, ish ndërtesa e Bankës Lubjanës, Kati i V-të, për shkak të anulimit të Vendimit Nr. PSH.nr. 89/18 i datës 20 Prill 2018, si i kundërligjshëm, pas përfundimit të shqyrtimit kryesorë në seancë publike më datë 11.03.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit A.E. pronar i Mercom Company, ndërsa në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, më datë 28.03.2024, merr këtë:

### A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** Në tërësi kërkesëpadia e paditësit MERCOM COMPANY SH.P.K, me seli në Prishtinë kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) me seli në Prishtinë, më çka ka kërkuar anulimin e Vendimit Nr. PSH.nr. 89/18 i datës 20 Prill 2018, i nxjerr nga e paditura OSHP, me propozim që gjykata të aprovoj padinë e paditësit në tërësi si të bazuar, të anulohet vendimi i OSHP-së me nr. PSH.nr. 89/18 i datës 20.04.2018 si i kundërligjshëm dhe çështja ti kthehet OSHP-së në rishqyrtim dhe rivendosje, të detyrohet paditësi të bëjë pagesën e shpenzimeve procedurale sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, ose të detyrohet e paditura, të bëjë kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga ekzekutimi i aktit administrativ dhe atë: fitimin e humbur për shkak të eliminimit kundërligjor të ofertës fituese të Mercom, kompensimin e shpenzimeve në lidhje me përgatitjen dhe pjesëmarrjen në aktivitetin tenderues dhe kompensimin e dëmit reputacional si rezultat i eliminimit kundërligjor, sipas specifikimeve përmes ekspertizës financiare, **si e pa bazuar.**

## II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

### A r s y e t i m

#### Historiku procedural

1. Më datë 22.05.2018, në Gjykatën Themelore të Prishtinës Departamenti për Çështje Administrative paditësi MERCOM Company SH.P.K, me seli Prishtinë, ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.nr. 1197/18, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit të Vendimit Nr. PSH.nr. 89/18 i datës 20 Prill 2018, i të paditurës OSHP, me propozim që gjykata të aprovoj padinë e paditësit në tërësi si të bazuar, të anulohet vendimi i OSHP-së me nr. PSH.nr. 89/18 i datës 20.04.2018 si i kundërligjshëm dhe çështja ti kthehet OSHP-së në rishqyrtim dhe Rivendosje, të detyrohet paditësi të bëjë pagesën e shpenzimeve procedurale sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, ose të detyrohet e paditura, të bëj kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga ekzekutimi i aktit administrativ dhe atë: fitimin e humbur për shkak të eliminimit kundërligjor të ofertës fituese të Mercom, kompensimin e shpenzimeve në lidhje me përgatitjen dhe pjesëmarrjen në aktivitetin tenderues dhe kompensimin e dëmit reputacional si rezultat i eliminimit kundërligjor, sipas specifikimeve përmes ekspertizës financiare.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 93/22.
3. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit përgatitor më datë 04.07.2023, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit avokat A.E. sipas autorizimit të datës 11.03.2024, ndërsa me pjesëmarrje të përfaqësuesit të palës së paditur N.K., dhe me më datë 11.03.2024 me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit avokat A.E. sipas autorizimit të datës 11.03.2024, ndërsa konform nenit 41 të LKA-së në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, e cila gjykatës më datë 06.03.2024 i ka dorëzuar parashtrësë për deklaram në seancë.

## Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në padi, në pretendimet e dhëna gjatë shqyrtimit kryesorë si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, vendimi i OSHP-së PSH.Nr.89/18/93/18 i datës 20.04.2018 është vendim i paligjshëm për anulimin e Aktivitetit Tenderues, “Faza e tretë-Ndërtimi i Palestrës Sportive në Komunën e Rahovecit”, me nr. të prokurimit. 207-17-2162-5-1-1, në të cilin aktivitet paditësi Mercom Company ka pasur ofertën më të lirë nga të gjitha kompanitë, dhe në përputhje me legjislacionin e fuqi ka qenë për obligim të shpërblehet me kontratë, si vendim është i kundërligjshëm, sepse për çështjen e anulimit ka pasur një vendim paraprak të OSHP-së ku është vendos se nuk mund të ketë anulim në tender dhe duet vazhduar me dhënie të tenderit.
  
5. Ka theksuar se, fillimisht pas hapjes së ofertave Autoriteti Kontraktues, tutje (AK) ka bërë anulimin e parë të aktivitetit Tenderues me datë 04.10.2017, bazuar në Ankesën e dorëzuar në OSHP nga Mercom Company, është përpiluar ekspertizë profesionale me të cilën është konstatuar se në këtë kontratë për Operatorin me të lirë të përgjegjshëm. Me konstatimet e ekspertizës janë pajtuar të gjitha palët dhe AK dhe përmes Njoftimit Nr. 320/17&339/17 OSHP ka përmbyllur shqyrtimin sipas Ankesës dhe ka kthyes lëndën në rishqyrtim. Së dyti në procesin e rivlerësimit AK shpërblen me kontratë Kompaninë Euro Besi, ndërsa pas ankesës së Mercom Company tani paditës OSHP-ja rikthen lëndën në rivlerësim. Së treti pas kthimit në rivlerësim AK refuzon të shpërblej me kontratë Kompaninë e cila i plotëson kushtet ligjore, Mercom Company dhe merr vendim për anulim të tërësishëm të tenderit. Vendimi i atakuar i OSHP-së është marrë në shkelje dhe interpretim të gabuar të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr 05/L-092. AK Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, tutje (MKRS) ka marr vendim për anulimin e aktivitetit tenderues, pas hapjes së ofertave. Anulimi është bërë me arsyetimin se nuk ka pasur përputhje të plotë në mes të versionit të dosjes së tenderit në gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe dhe angleze, kjo në raport me një pozicion tërësisht të parëndësishëm në paramasë dhe parallogari. Versioni në gjuhën serbe dhe gjuhën angleze i dosjes së tenderit ka pasur si shtesë një pozicion tejet pa rëndësi, kjo në lidhje me disa pjesë të sanitarisë dhe i cili pozicion ka

munguar në gjuhën shqipe Në mënyrë të njëjtë dhe të gjitha ofertat janë dorëzuar në gjuhën shqipe. Diferenca në mes të pozicionit i cili ka qenë si shtesë në paramasë dhe parallogari në gjuhën angleze dhe serbe, në krahasim me versionin në gjuhën shqipe është më pak se 1%, nga vlera e përgjithshme e kontratës.

6. OSHP-ja ka interpretuar në mënyrë të gabuar edhe dispozitat e Ligjit të Prokurimit, përkatësisht nenet 6,7,13,59 dhe 62, kur ka vërtetuar njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit të AK-së. OSHP-ja përmes vendimit të atakuar ka bërë anulimin e aktivitetit tenderues duke konstatuar se ky aktiviteti i prokurimit duhet të anulohet për shkak se AK, nuk ka qenë në gjendjen të ruaj ndryshimet e synuara në dosjen e tenderit. Kjo është në kundërshtim me njoftimin e OSHP-së me numër 230/17&339/17 dh me vendimin e OSHP-së 445/17, përmes të cilave është vendosur që aktiviteti nuk mund të anulohet në këtë fazë, dhe se vlerësimi i ofertave duhet bërë në përputhje me Dosjen e Tenderit, e cila është vërtetuar nga KRPP-ja dhe Tavolina Ndihmëse, nuk është ndryshuar asnjëherë. Gjithashtu nenin 62 i LPP-së nuk lejon anulimin pas hapjes së ofertave në rast se ka së paku 1 ofertë të përgjegjshme. Kjo për arsye se mundësia për anulim të aktivitetit tenderues i jep hapësirë për manipulim AK-së. Në përputhje me nenin 59.3 AK këto diferenca të cilat tek asnjë Operator Ekonomik (OE), nuk e kalojnë 2% të vlerës së ofertës, ka qenë i obliguar të bëjë përmirësimin e gabimeve aritmetikore. Kjo ose duke larguar tërësisht këto pozicione, apo duke i shtuar bazë dhe duke e shumëzuar për njësitë të cilat kërkohen. Në këtë bazë, në Dosjen e Tenderit në gjuhën shqipe, tek pjesët e sanitarisë, sasia e kërkuar ka qenë zero (0), derisa Mercom Company SH.P.K. veçse e ka vendosur çmimin për njësi për pjesët e kërkuara, të përshkruara si: Elementet sanitare si Sigurimi dhe Montimi i ËC-ulëseve, komplet me kazan dhe EK valvulen, çmimi 150 euro, Sigurimi dhe Montimi i pasuarit komplet me lëshuesen e ujit, çmimi 120 euro, Sigurimi dhe Montimi i lavapjatave për larjen e enëve, çmimi 100 euro, Sigurimi dhe Montimi i garniturës, çmimi 125 euro. I propozon gjykatës të aprovoj në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, të anulohet vendimi i OSHP-së me nr. PSH.nr.89/18 i datës 20.04.2018, si i kundërligjshëm dhe çështja ti kthehet OSHP-së në rishqyrtim dhe rivendosje. të detyrohet paditësi të bëjë pagesën e shpenzimeve procedurale sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, ose të detyrohet e paditura, të bëjë kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga ekzekutimi i aktit administrativ dhe atë:

fitimin e humbur për shkak të eliminimit kundërligjor të ofertës fituese të Mercom, kompensimin e shpenzimeve në lidhje me përgatitjen dhe pjesëmarrjen në aktivitetin tenderues dhe kompensimin e dëmit reputacional si rezultat i eliminimit kundërligjor, sipas specifikimeve përmes ekspertizës financiare.

#### Kundërshtimet e të paditurës

7. Përfaqësuesi i të paditurës në përgjigje në padi sipas parashtrës së datës 29.05.2023, dhe në seancë ka deklaruar se Autoriteti Kontraktues “Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit”, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është punë kontratë publike me vlerë të madhe Operatori Ekonomi (OE) ankues: “Mercom Company”, SH.P.K., dhe OE “Euro Besi”, SH.P.K., kanë parashtruar ankesa, kundër rekomandimit të komisionit ri-vlerësues për anulim të aktivitetit të prokurimit. Kundër të njëjtit njoftim, parashtruesit e ankesave kanë paraqitur kërkesa për ri-shqyrtim tek AK, dhe të njëjtat janë refuzuar si të pa bazuara nga AK. Përmes raportit të ekspertizës së datës 27.09.2017 me nr. 320-339/17, janë pasqyruar ofertat e OE pjesëmarrës në aktiviteti të prokurimit, kundrejt arsyetimit të dhënë për anulim ku AK, kishte potencuar se sasia për pozicionet e elementeve të sanitarisë, platforma nuk i ka ruajtur sasitë në gjuhën shqipe. OE “Euro-Besi” SH.P.K., dhe OE NPN “Eurosing”, kanë pasur të përshkruar njësisë, sasitë dhe çmimet, ndërsa OE “Mercom Company” SH.P.K dhe OE të tjerë pjesëmarrës në Aktivitet të Prokurimit nuk kishin të përshkruara sasitë, prandaj nga rekomandimi i dhënë AK-së që përmes rivlerësimit të ofertave të bëhet krahasimi dhe ekzaminimi real me qëllim të krahasimit të pozicioneve (sasive) të ofruara nga OE, me pozicionet e aplikuara nga AK dhe të vepohet sipas dispozitave të LPP-së pasi që AK përmes raportit të vlerësimit kishte potencuar se dy OE kanë ofertuar me paramasë të kompletuar dhe të tjerët të pa kompletuar. Kundrejt këtij rekomandimi Paneli Shqyrtues i OSHP-së më datë 03.10.2017, ka nxjerr njoftim, sipas nenit 19.6 të rregullores së punës së OSHP-së, në kuptim të rivlerësimit të ofertave. AK pas rivlerësimit të ofertave konkretisht komisioni rivlerësues përmes raportit ka potencuar rezulton të jenë dy oferta të përgjegjshme dhe rekomandon për dhënie OE “Euro Besi” SH.P.K., Përderisa përmes arsyetimit të vendimit kundrejt kërkesës për rishqyrtim potencon se OE “Euro Besi” SH.P.K., dhe OE NPN “Eurosing”, kanë

dorëzuar oferta me paramasë të kompletuar, në kuptim të asaj që platforma i ka ruajtur ndryshimet.

8. Ka theksuar se OE “Mercom Company” SH.P.K., më datë 14.11.2017, ka parashtruar ankesë në OSHP ndërsa paneli shqyrtues i OSHP-së më datë 20.1.2017 nxjerr vendim me nr. 445/17 dhe e aprovon ankesën si të bazuar dhe lëndën e kthen në rivlerësim, me arsyetim se AK gjatë rivlerësimit duhet të vërtetoj dhe të sqaroj se a është ndryshuar dosja e tenderit dhe të vërtetohet dhe të sqarohet në detaje se a është ndryshuar sasia tek paramasa për “Elementet e Sanitarisë” dhe nëse është ruajtur sasia atëherë të vërtetohet se a janë ruajtur ndryshimet. Paneli shqyrtues sqaron se AK vepruar sipas vendimit të panelit shqyrtues nr. 445/17 të datës 20.12.2017, duke ju drejtuar më datë 09.01.2018 Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik, tutje (KRPP) për të sqaruar se a është ndryshuar paramasa dhe paralogaria, ndërsa më datë 22.01.2018 KRPP-ja është përgjigjur se “Në procedurën e prokurimit figuron se versioni i fundit i dosjes së tenderit është i datës 22.05.2017, tek përshkrimi i çmimeve figuron se përshkrimi i fundit është versioni i fundit i datës 19.05.2017. Më datën 23.06.2017 zyrtarja ka tentuar për të bërë ndryshimin e dosjes elektronike, por këto ndryshime nuk janë bërë në sistem nga AK në asnjë version gjuhësor, dosja aktuale në sistem është e datës 22.05.2017, që do të thotë se tek dosja e tenderit nuk ka ndryshime pas kësaj date, ndërsa përshkrimi i çmimeve në sistem është i datës 19.05.2017, që do të thotë se tek ndryshimi i çmimeve nuk ka ndryshime pas kësaj date në asnjë version gjuhësorë. Nëse ka qenë e nevojshme të ndryshohet lista e çmimeve sikur në këtë rast, atëherë AK është dashur të bëjë ndryshimin e listës së çmimeve, e jo Dosjes së Tenderit, siç ka tentuar ta bëjë AK, andaj ky ndryshim ka rezultuar pa sukses.
9. Për më tepër duke e pasur parasysh sqarimet që i ka bërë KRPP-ja paneli shqyrtues ka konstatuar se ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet, me qëllim të trajtimit në mënyrë të barabartë të gjithë Operatorëve Ekonomik, sipas nenit 7 të LPP-së dhe vjen në përfundim se lëshimet që janë bërë me rastin e përpjekjes nga ana e AK-së për të ndryshuar dosjen e tenderit, të cilat ndryshime nuk janë ruajtur, kanë sjellur një situatë ku nuk mund të riparohen dhe korrigjohen ato lëshime. I ka propozuar gjykatës që të

refuzoj padinë e paditësit si tërësisht të pa bazuar, dhe të vërtetoj vendimin e OSHP-së Nr. Psh.89-93/2018 të datës 20.04.2018, si i ligjshëm.

#### Provat e administruara

10. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: vendimi PSH.nr. 445/2017 i datës 06.12.2017, vendimi nr. 93/2018 i datë 11.04.2018, Njoftimi i OSHP-së me nr. të referencës 320/2017 939/2017 i datës 03.10.2017, ankesa nga operatori ekonomik Mercom Company e datë s07.03.2018, Procesverbali i hapjes së tenderit me nr. të prokurimit. 207-17-2162-5-1-1 i datës 28.06.2017, shkresë lidhur me zbatimin e rekomandimeve të vendimeve të OSHP-së me nr. të protokollit 379/2018 e datës 09.02.2018, komunikimi elektronik përmes emailit, ekspertiza financiare e datës 15.02.2024, e përgatitur nga eksperti A.Z..
11. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaratimet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar. Nga provat e administruara gjykata vërtetoj këtë gjendje faktike:
12. Nga Procesverbali i hapjes së tenderit me nr. të prokurimit. 207-17-2162-5-1-1 i datës 28.06.2017, është hapur tenderi nga Autoriteti Kontraktues titulli i kontratës “Faza e tretë-Ndërtimi i palestrës Sportive në Komunën e Rahovecit”, me numër të prokurimit 207-17-2162-511, i hapur më datë 28.06.2017. Me datë 07.03.2018 Operatori ekonomik Mercom Company, “Mercom Company” ka parashtruar ankesë në tenderin me titull “ Faza e tretë-Ndërtimi i palestrës Sportive në Komunën e Rahovecit”, me numër të prokurimit 207-17-2162-511, të iniciuar nga AK Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

13. Paneli Shqyrtues i Prokurimit Publik me vendim PSH.nr. 445/2017 i datës 06.12.2017, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e OE “Mercom Company” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Faza e tretë-Ndërtimi i Palestrës Sportive në Komunën e Rahovecit” me nr. prok. 207/17/2162/511, të iniciuar nga AK Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, dhe e ka anuluar njoftimin për dhënie të kontratës të AK Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit në Komunën e Rahovecit me nr. të prok. 207/17/2162/511 dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim, me arsyetim se AK gjatë rivlerësimit të ofertave të vërtetohet dhe të sqarohet se a është ndryshuar dosja e tenderit dhe konkretisht të vërtetohet dhe të sqarohet në detaje se a është ndryshuar sasia të paramasa tek elementet e sasisë dhe nëse është ndryshuar sasia atëherë të vërtetohet se a janë ruajtur ndryshimet. Këto verifikime duhet të bëhen me qëllim të nxjerrjes së vendimit meritor pasi që AK pretendon se ndryshimet janë bërë, mirëpo nuk janë ruajtur në versionin e gjuhës shqipe, ndërsa në versionin e gjuhës angleze dhe serbe janë ruajtur.
14. Departamenti i prokurimit i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, në shkresë lidhur me zbatimin e rekomandimeve të vendimeve të OSHP-së me nr. të protokollit 379/2018 e datës 09.02.2018, ka njoftuar panelin shqyrtues të Prokurimit Publik se Zyra e prokurimit ka komunikuar me ekipin ndihmës në këtë fazë të rivlerësimit, dhe i kanë njoftuar se ndryshimet nuk janë ruajtur. Rekomandimet e komisionit janë se ky aktivitet i prokurimit të anulohet dhe të ri tenderohet. Rekomandimi i komisionit Rivlerësues është që të sigurohet qasje e barabartë për të gjithë OE për këtë aktivitet të prokurimit.
15. Paneli Shqyrtues vendimi me vendim nr. 93/2018 i datë 11.04.2018 e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesat e OE “Mercom Company” dhe OE “Euro Besi” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Faza e tretë Ndërtimi i palestrës Sportive në Komunën e Rahovecit”, me numër të prokurimit 207-17-2162-511, të iniciuar nga AK Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, dhe e ka vërtetuar njoftimin për anulim të AK Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Faza e tretë Ndërtimi i Palestrës Sportive në Komunën e Rahovecit” me nr. prok. 207/17/2162/511, iniciuar nga AK Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, me arsyetim se Paneli shqyrtues sqaron se AK ka vepruar sipas



vendimit të panelit shqyrtues nr. 445/17 të datës 20.12.2017, më datë 09.01.2018 i është drejtuar Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik, tutje (KRPP) për të sqaruar se a është ndryshuar paramasa dhe paralogaria, ndërsa KRPP-ja më datë 22.01.2018 është përgjigjur se “Në procedurën e prokurimit figuron se versioni i fundit i dosjes së tenderit është i datës 22.05.2017, tek përshkrimi i çmimeve është versioni i fundit i datës 19.05.2017. Më datën 23.06.2017 zyrtarja ka tentuar për të bërë ndryshimin e dosjes, por këto ndryshime nuk janë bërë në sistem nga AK në asnjë version gjuhësor, dosja aktuale në sistem është e datës 22.05.2017, që do të thotë se tek dosja e tenderit nuk ka ndryshime pas kësaj date, ndërsa përshkrimi i çmimeve në sistem është i datës 19.05.2017, që do të thotë se tek ndryshimi i çmimeve nuk ka ndryshime pas kësaj date në asnjë version gjuhësorë. AK është dashur të bëjë ndryshimin e listës së çmimeve, e jo Dosjes së Tenderit, siç ka tentuar ta bëjë AK, andaj ka rezultuar pa sukses ky ndryshim, duke e pasur parasysh sqarimit që i ka bërë KRPP-ja paneli shqyrtues ka konstatuar se ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet, me qëllim të trajtimit në mënyrë të barabartë të gjithë Operatorëve Ekonomik.

16. Gjykata vlerëson Vendim nr. 93/2018 i datë 11.04.2018 me të cilin është aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesat e OE “Mercom Company” dhe OE “Euro Besi” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Faza e tretë Ndërtimi i palestrës Sportive në Komunën e Rahovecit”, me numër të prokurimit 207-17-2162-511, të iniciuar nga AK Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, dhe është vërtetuar njoftimin për anulim të AK Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Faza e tretë Ndërtimi i Palestrës Sportive në Komunën e Rahovecit” me nr. prok. 207/17/2162/511, iniciuar nga AK Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, është në përputhje me Ligji nr. 04/l-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës neni 7 përcakton Barazinë në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, paragrafi 1 specifikon se “*Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*”. Sepse sipas sqarimit të Departamenti i prokurimit i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, në shkresë lidhur me zbatimin e rekomandimeve të vendimeve të OSHP-së me nr. të protokollit 379/2018 e datës 09.02.2018, Paneli shqyrtues ka vlerësuar të mjaftueshëm dhe bindës sqarimin e AK lidhur me ndryshimin e paramanës dhe

parallogaria, sepse për shkak të gabimeve në përshkrimin e çmimeve është tentuar të bëhet ndryshimi i dosjes, në vend që të ndryshohen çmimet çka ka ndikuar që ndryshimet të mos ruhen në sistem, dhe kjo ka sjellur një situatë ku nuk kanë mund të riparohen dhe korrigjohen ato lëshime ashtu që në dosje të tenderit në gjuhën shqipe, tek pjesët e sanitarisë, tek sasia nuk është parashikuar ndonjë sasi dhe rubrika të kjo pjesë ka mbetur e zbrazët, korrigjimi ka qenë i riparueshëm. Neni 62 i Ligjit nr. 04/1-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës përcakton se kur mund të përfundimi një aktivitetit të prokurimit *1. Autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës për njëërën nga arsyet: 1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit*, prandaj Gjykata vlerëson se anulimi i aktivitetit të prokurimit është bërë me rekomandim të Komisionit dhe të Panelit Shqyrtues sipas nenit 7 të LPP-së dhe vjen në përfundim se lëshimet që janë bërë me rastin e përpjekjes nga ana e AK-së për të ndryshuar dosjen e tenderit, të cilat ndryshime nuk janë ruajtur pasi anulimi është bërë me qëllim të trajtimit në mënyrë të barabartë të gjithë Operatorëve Ekonomik dhe është në pajtim me dispozitat ligjore të cituara më lart.

17. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.93/22, datë 28.03.2024

Gjyqtarja  
Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.